



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/267
Datë: 15.08.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Kregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 24.236,29€ (njëzetekatër mijë e dyqind e tridhjetegjashhtë euro e njëzetënëntë centë), si dhe bëhet shtimi i 10 (dhjetë) pozitave të reja në Komunën e Mitrovicës Veriore, me kod 647, mjetet dhe numri i pozitave ndahen në nënprogramet si vijim:
 - 1.1. Në nënprogramin "Sporti dhe rekreacioni", me kod 85118, ndahet shuma prej 16.058,89€ (gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetetë euro e tetëdhjetenëntë centë) në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe shtesa", si dhe bëhet shtimi i 7 (shtatë) pozitave të reja;
 - 1.2. Në nënprogramin "Shërbimet kulturore", me kod 85038, ndahet shuma prej 8,177.40€ (tetë mijë e njëqind e shtalëdhjeteshtatë euro e dyzet centë) në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe shtesa", si dhe bëhet shtimi i 3 (tri) pozitave të reja.
 - 1.3. Pozitat e reja të përmendura në pikat 1.1. dhe 1.2. do të regjistrohen sipas tabelës së bashkangjitur këtij Vendimi.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi, si dhe numri i pozitave merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, nga nënprogrami "Kontingjencat në Ministrinë e Financave", me kod 28900, kategoria e shpenzimeve "Paga dhe shtesa".
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Komuna e Mitrovicës Veriore për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Nr.rend.	Koef.	Vlera e koef.EUR	Paga bazë	Pervoja mesatare 5 vite nga 0.5% rritje ne vit	Paga baze + pervoja e punes	Muaj	Paga bruto	Kontrib.punedh.5%	Shuma per ndarje sipas vendimit
1	5.58	110	613.80	15.35	629.15	4	2,516.58	125.83	2,642.41
2	4.96	110	545.60	13.64	559.24	4	2,182.40	109.12	2,291.52
3	4.76	110	523.60	13.09	536.69	4	2,094.40	104.72	2,199.12
4	4.76	110	523.60	13.09	536.69	4	2,094.40	104.72	2,199.12
5	4.96	110	545.60	13.64	559.24	4	2,182.40	109.12	2,291.52
6	4.80	110	528.00	13.20	541.20	4	2,112.00	105.60	2,217.60
7	4.80	110	528.00	13.20	541.20	4	2,112.00	105.60	2,217.60
Sporti dhe rekreacioni 85118							15,294.18	764.71	16,058.89
1	5.90	110	649.00	16.23	665.23	4	2,596.00	129.80	2,725.80
2	5.90	110	649.00	16.23	665.23	4	2,596.00	129.80	2,725.80
3	5.90	110	649.00	16.23	665.23	4	2,596.00	129.80	2,725.80
Shërbimet kulturore 85038							7,788.00	389.40	8,177.40
Total						-	23,082.18	1,154.11	24,236.29



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/267
Datë: 15.08.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 15, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë c Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për transfer të mjeteve buxhetore, në shumë prej 2,300,000€ (dy milionë e treqind mijë euro), deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të kategorisë së shpenzimeve "Investime kapitale", për përkrahjen financiare të Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM), për blerjen e makinerive të avancuara prodhuese dhe përpunuese.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me kod 204, nga kategoria e shpenzimeve "Investime kapitale", nga nënprogrami "Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë", me kod 49000, nga projekti "Ndërtimi i Zonave Ekonomike nëpër Kosovë", me kod 12664, dhe transferohen në kategorinë e shpenzimeve të "Subvencioneve dhe Transfereve" në nënprogramin "Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë", me kod 49000.
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/267
Datë: 15.08.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 19/A të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-115, Ligjin Nr. 05/L-080 dhe me Ligjin Nr. 06/L-023, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për kthimin e fondeve në shumën prej 489,932.72€ (katërqind e tetëdhjetenëntë mijë e nëntëqind e tridhjetedy euro e shtatëdhjetedy centë), të transferuara në Buxhetin e Republikës së Kosovës, për Ndërmarrjen Shoqërore PRN046 "FAN Zahir Pajaziti".
2. Mjetet buxhetore merren nga kodi i pranimit të këtyre të hyrave dhe nga llogaria kryesore e BRK-së dhe kthehen në llogarinë e ndërmarrjes shoqërore, sipas pikës I. të këtij Vendimi, me qëllim që ndërmarrjet shoqërore të kenë mjete të mjaftueshme për t'i përmbushur kërkesat kreditore, apo për t'i mbuluar shpenzimet e likuidimit, sipas prioriteteve të përcaktuara në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/267
Datë: 15.08.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 49, 50 dhe 52 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 38 të Ligjit Nr. 08/L-099 për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, të nenit 24 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim kërkesa për huamarrje deri në 2,540,000€ (dy milionë e pesëqind e dyzet mijë euro) për Radio Televizionin e Kosovës (RTK), për qëllime të likuiditetit të transmetuesit publik, subjekt i aprovimit nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve.
2. Obligohet Thesari që për huadhënien ndaj transmetuesit publik t'i bëjë transferet dhe regjistrimet e nevojshme në regjistrat kontabël, në kuadër të Sistemit Informatik për Menaxhimin e Financave të Kosovës.
3. Mjetet e huadhënies, sipas këtij Vendimi, përdoren vetëm për qëllimin e miratuar dhe nuk janë subjekt i asnjë kufizimi, pretendimi dhe detyrimi nga palët e treta.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë